



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

VENDIM

Nr. 36, Datë 21/12 /2016

PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 21.12.2016 në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” si dhe të vendimit të dërguar nga Bashkia Vlorë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr. 55, datë 06.12.2016 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues *Znj. Tarikë Bejo (subjekti Znj. Tarikë Bejo ,gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991*» për një objekt banimi (1 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 55.0 m² dhe sipërfaqe truall funksional 300 m², me vendndodhje në fshatin Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë zona kadastrale 3621, nr. pasurie nr. 855/2 që kufizohet nga Veriu me pasurinë me nr. 111 rrugë, Jugu me pasurinë nr.855 Imet Troqe, nga Lindja me pasurinë nr. 852 Habip Troqe dhe nga Perëndimi me pasurinë 855/2 vet i zoti.

KRYETARI I KËSHILLIT QARKUT

Sadrit DANAJ
